

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN KRYEVIDH, KAVAJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Kryevidh me objekt: “Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimit për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, legalizimin e shtesave në ndërtime, dhënien me qira të objekteve pronë publike, procesin e ndarjes së tokës bujqësore, etj.” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.3 , datë 23.01.2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 326/6, datë 23.01.2012, dërguar **z. Fatos Kaja**, Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të zbatohen detyrat e rekomanduara nga KLSH, me shkresën nr. 257/11, datë 16.10.2008, për arkëtimin e vlerës mbetur dhe kërkimin e masave administrative.

Menjëherë

2. Nga ana e Zyrës së Taksave të Komunës Kryevidh.

2.1- të hartohen planet vjetorë për ushtrimin e kontroleve në drejtimet e përcaktuara në Pikën 10“Kontrolli tatimor” të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore” .

2.2- të merren masa për hedhjen e regjistrit të tatimpaguesve dhe debitorëve të tokës, në sistem elektronik. Ndërkohë të kryhet edhe inventarizimi i dosjeve të subjekteve të biznesit të vogël, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

2.3- për 69 subjekteve debitorë në shumën **4.357.614 lekë**, t’i kërkohet Drejtorinë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore”.

2.4- të vazhdojnë arkëtimi i debitorëve të tokës për vlerën **8.707.000 lekë**, të cilat përfaqësojnë 832 familje debitorë nga viti 2009 në vlerën 3.306.000 lekë dhe 1090 familje debitorë për vitin 2010 në vlerën 5.401.000 lekë. (lista me Fermerët debitorë është e pasqyruar në regjistrat e debitorëve të tokës të cilën e disponon zyra e taksave të Komunës)

2.5- nga ana e Zyrës së Taksave dhe Policisë së Komunës të hartohet paketa me llojet dhe masën e gjobës, duke i propozuar Këshillit të Komunës, të vendosë masën e gjobës për llojet e çdo shkelje të cilat përbëjnë kundravajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative”

2.6- Për të ardhmen korrespondenca ndërmjet Zyrës së taksave dhe Policisë së komunës të bëhet zyrtarisht nëpërmjet protokollit.

Menjëherë

3. Nga ana e Policisë së Komunës, të hartohet plani i kontrollit vjetor dhe të merren masat që puna e përditshme e saj të dokumentohet në mënyre shkresore, duke zbatuar kërkesat e Kreut VII-të urdhrin të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të komunës”.

Menjëherë

4. Të inventarizohet dokumentacioni që përmbajnë Dosjet e Inspektoratit ndërtimor dhe prokurimeve publike dhe të dorëzohen në zyrën e arkivit të komunës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregullores së nxjerrë për këtë qëllim. “Për Arkivat”.

Menjëherë

5. Të plotësohen Dosjet e Personelit me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në Aneksin I dhe II të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe Regjistrin të Personelit”

Menjëherë

6. Të lidhen kontratat individuale me punonjësit e Komunës, ku të parashikohen edhe llojet e masave disiplinore, siç përcaktohet në nenet 12, 21 dhe 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës”, ndryshuar me ligjet nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 9125 datë 29.07.2003.

Menjëherë

7. Nga Inspektorati Ndërtimor i Komunës, të hartohen planet vjetorë për ushtrimin e kontrolleve në drejtimit e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime.

Menjëherë

8. Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës Kryeviidh, në bashkëpunim me Juristin e Komunës, të nisnin procedurat ligjore për ekzekutimin e 8 gjobave, siç përcaktohet në nenet 9, 22 dhe 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, si më poshtë:

a) - nga mbikëqyrësi i punimeve ■■■ gjoba në masën 100.000 lekë + 40.000 lekë, kamat vonesa për 20 muaj = **140.000 lekë**, (rekomandim i pa zbatuar dërguar me shkresën e KLSH, nr. 257/11, datë 16.10.2008)

b) - nga 7 kundravajtës të cilët kanë kryer ndërtime pa lejë (Hotele), në vlerën 14.000.000 lekë + 2.800.000 lekë, (kamat vonesat 2% në muaj) = **16.800.000 lekë, sipas listës më poshtë:**

N	Emër Mbiemër	Vendimi i Gjobë		Gjithësi e Gjobës	Gjoha në Lekë	Muaj Punë	Muaj	Kamat Vonesa Lekë	Gjithsejtë Gjobe + KamatVon	Gjendje ekt Dt.20.9.11
		ria	Data							
	b	1	2	3	4	5	6	8	8	9
1	Med Muca	001	20.12.2010	Hote1	2.000.0000	9	18	360.000	2.360.000	E ndertuar
2	Skender Hoxha	002	20.12.2010	Hote1	2.000.0000	9	18	360.000	2.360.000	E ndertuar
3	Hamit Muca	003	21.12.2010	Hote1	2.000.0000	9	18	360.000	2.360.000	E ndertuar
4	Alban Hoxha	004	21.12.2010	Hote1	2.000.0000	9	18	360.000	2.360.000	E prishur
5	Gjergj Syziu	005	21.12.2010	Hote1	2.000.0000	9	18	360.000	2.360.000	E ndertuar
6	Irakli Leka	007	25.02.2011	Hote1	2.000.0000	8	16	320.000	2.320.000	E prishur
7	Sybi Jahaj	008	25.02.2011	Hote1	2.000.0000	8	16	320.000	2.320.000	E prishur
	Totali				14.000.000			2.800.000	16.800.000	

Menjëherë

9. Për 4 personat të cilët kanë ndërtuar Hotel, pa lejë në zonën Turistike Spille dhe të cilët nuk i kanë prishur ato, ndërkohë nuk kanë paguar as edhe gjobën e vendosur përkatësisht: [REDAKTUAR] t'i kërkohet Inspektoratit Urbanistik Qendror, zbatimi i vendimeve të prishjes, bazuar në nenin 9 shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e ndërtimit"

Menjëherë

10. Të përgatitet dokumentacioni për nxjerrjen në ankand të **Mjeti tip Foristradë targë**, siç përcaktohet në vendimin e KM nr. 1242, datë 16.12.2009 "Pë rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxiret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor" dhe deri në realizimin e tij të ndërpritet furnizimi me karburant.

Menjëherë

11- Të njoftohet shoqëria "[REDAKTUAR]", për **riafaltimin e trupit të rrugës, në pjesët e dëmtuara**, për arsye të çarjes në disa vende të shtresave të asfaltit në rrugën kryesore lagja Çame - Kryevidh. Pasi afati i garancisë për objektet që kanë destinacion përdorimi afat gjatë është 10 vjet, siç përcaktohet në nenin 866, të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", me ndryshime,

Menjëherë

12. Të njoftohet shoqëria [REDAKTUAR] për riparimin e 20 ml rrugë, për arsye të rrëshqitjes, në rrugën e fshatit Stërbeg. Pasi afati i garancisë për objektet që kanë destinacion përdorimi afat gjatë është 10 vjet, siç përcaktohet në nenin 866, të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", me ndryshime.

Menjëherë

13. Komuna Kryevidh të rivlerësojë dhe të bëjë hyrje **Kamionin Tip "Volva"** targa....., dhuruar nga Komuna Golem (Rezervat shtetërore Durrës 2006). Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", me VKM nr.70 datë 11.03.1985.

Menjëherë.

14. Komuna Kryevidh të bëjë hyrje materialet për vlerën **295.300 lekë** të blera për 2 automjetet e komunës, sipas urdhër shpenzimit nr.30 datë 05.04.2011, përjashtuar 4 goma me vlerë 72.000 lekë të cilat janë bërë hyrje. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", me VKM nr.70 datë 11.03.1985.

Menjëherë.

15. Nga ana e administratës së Komunës Kryevidh, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" nenin 32 "detyrat dhe kompetencat e Këshillit Komunal ose bashkiak", shkronja (ç), të hartohet dhe të miratohet:

a) Rregullorja e Brendshme e Komunës "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së komunës Kryevidh"

b) Rregullorja e funksionimit të Këshillit Komunal.

Në mbledhjen e radhës

B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

Të kërkohet në rrugë ligjore vlera **1.504.268 lekë**, nga të cilat:

1-Vlera 42.600 lekë nga shoqëria [REDAKTUAR], për punë të pakryer në objektin "Rikonstruksion i rrugës kryesore lagja Çame, Kryevidh" (për të cilën është mbajtur proces verbali nr. 09, datë 21.09.2011)

Menjëherë

2-Vlera 81.600 lekë, nga shoqëria “██████████”sh.p.k, për punë të pa kryer në objektin “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Ballaj-Ostrec, Kryeviidh” (për të cilën është mbajtur proces verbali nr. 08,datë 21.09.2011)

Menjëherë

3-Vlera 213.300 lekë, nga shoqëria ██████████, për punë të pakryer, në objektin “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Stërbeg Kryeviidh”, (për të cilin është mbajtur proces verbalin 03,datë 21.09.2011) .

Menjëherë

4-Vlera 160.000 lekë, nga ██████████ ish Jurist i jashtëm, në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, paguar për 6 tendëra me urdhër shpenzimin nr. 50, datë 23.12.2009 në vlerën 120.000 lekë dhe urdhër shpenzimin nr.131,datë 14.12.2010 paguar për 2 tendera në vlerën 40.000 lekë. Kjo pagesë është kryer pa kontratë dhe në kundërshtim me Kreun e V, ”Zhvillimi i Procedurave”, pika 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”,shkronja (a).

Menjëherë

5-Vlera 160.000 lekë,nga ██████████ ish Jurist i jashtëm, në Njësinë e Prokurimit, (njëherazi punonjës i Bashkisë Kavajë), paguar për 6 tendëra me urdhër shpenzimin nr. 50, datë 23.12.2009 në vlerën 120.000 lekë dhe urdhër shpenzimin nr.131,datë 14.12.2010 paguar për 2 tendera në vlerën 40.000 lekë. Kjo pagesë është kryer pa u lidhur kontratë,ku përveç kësaj meqenëse ██████████ ka qenë punonjës i Bashkisë Kavajë, nuk ka marrë autorizimin e Bashkisë Kavajë, siç përcaktohet në pikën 5 të VKM nr. 714, datë 22.10.2004 “ Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike, Kap I -rë “Veprimtaritë e jashtme të nëpunësve të administratës publike “

Menjëherë

6 - Vlera 667.386 lekë, nga ██████████ ish kryetari i Komunës, e cila përfaqëson harxhimin e 5.400 litra karburant sipas fletëdaljes nr.140, datë 19.08.2010, (nënshkruar nga vetë ish kryetari i komunës), për përdorimin e mjetit Tip Foristradë me targë, ndërkohë që mjeti duhet të kishte dalë në ankand. Në kundërshtim me Kreun I-rë, pika 1 , të VKM nr. 1242, datë 16.12.2009 “ Pë rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit,procedurat e zhvillimit të ankandit,kriteret e vlerësimit të pronës,që nxiret në ankand,si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 1,datë 21.01.2010”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010” Pika 1.2-TË TJERA, pika 16.

Menjëherë

7. Vlera 90.382 lekë, nga ish shofer i kryetarit të komunës, për udhëtim e dieta me jashtë shtetit, sipas urdhër shpenzimit nr. 13, datë 19.02.2009, veprim në kundërshtim me VKM nr. 304, datë 08.05.2003 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit”.

Menjëherë

8. Vlera 15.000 lekë, nga ish kryetari i komunës, për përfitim udhëtim e dieta brenda vendit në distanca nga qendra e punës nën 100 km (Kryeviidh-Tiranë etj) sipas listë pagesave të muajit qershor të vitit 2011, veprim në kundërshtim me pikën III/1 të VKM nr. 997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar te punonjëset qe dërgohen me shërbim jashtë qendrës se punës brenda vendit”.

Menjëherë

9. Vlera 62.000 lekë,nga ish kryetari i komunës, për tejkalim të limitit për telefoninë e lëvizshme (celulare) në 10 muaj (Shtator 2009 deri Qershor 2010), pasi nga 5.000 lekë/muaj ka harxhuar 15.000 lekë/muaj, konkretisht sipas urdhër shpenzimit nr.86, datë 24.09.2010, fletëhyrjes nr.21/1, datë 20.09.2010 dhe fletëdaljes nr.174, datë 20.10.2010. Veprim në kundërshtim me pikën 2 VKM-së nr. 343 datë 11.07.2002“Për pajisjen me numër celulari të punonjësve të administratës publike” me ndryshimet e mëvonshme dhe pika 9 e VKM nr. 864, datë 23.07.2010.

Menjëherë

10. Vlera 12.000 lekë, nga ■■■ për tejkalimin e limitit për telefoninë e lëvizshme (celulare) në 6 muaj (Janar- Qershor 2010), pasi nga 5.000 lekë/muaj që i takon, ka harxhuar 7.000 lekë/muaj, konkretisht sipas fletëdaljes nr.166, datë 15.10.2010. Veprim në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 343, datë 11.07.2002 “Për pajisjen me numër celulari të punonjësve të administratës publike” me ndryshimet e mëvonshme dhe pika 9 e VKM nr. 864, datë 23.07.2010.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të neni 7, pikës 1, 3, 4 paragrafi ¾. 17, 18, 19, pikës 3, 3/a,b,c, 7/e të UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, pikës 8, 8/1, 8/2, 10, të kreut 2, pikat 4, 5 të kreut III të UKM nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” i propozohet:

Kryeinspektorit të Inspektoratit të Ndërtimor dhe Urbanistik, pranë Komunes Kryevidh, të gjobisë në shumën 50.000 lekë, Ing. ■■■ me numër Liçence MK .1033, në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve në objektin “Rikonstrukcion i rrugës kryesore lagja Çame, Kryevidh”, e cila është paguar në vlerën 148.582 lekë, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se:

a)- janë raportuar më tepër 2 zëra punimesh duke krijuar një dëm ekonomik për buxhetin e Komunes Kryevidh në vlerën 42.600 lekë.

b)- nga verifikimi në objekt i punës së kryer, rezultoi se shtresat asfaltime të rrugës në disa vende ishin çarë në drejtimin gjatësorë të rrugës si rezultat i rrëshqitjes së shtratit të rrugës. Projekti i këtij objekti është hartuar në mungesë të studimit gjeologjik të rrugës, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

c) -nga Mbikëqyrësja e punimeve Ing. ■■■ janë kryer shkeljet ligjore të mëposhtme:

1-Nuk është zbatuar pika 5 e udhëzimit të KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pasi në çastin e fillimit të punimeve, mbikëqyrësja e punimeve nuk ka kryer verifikimet paraprake, si më poshtë vijojnë:

1.1- Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të liçencave, të autorizimeve dhe lejeve të cilat, sipas dispozitave në fuqi, duhet të merren para fillimit të punimeve. (shkronja -d-)

1.2- nuk është vendosur në dosjen e zbatimit të objektit, vendimi i KRRT, për sheshin ose lejen e ndërtimit, Paragrafi 4 , shkronja (a),

1.3- mbikëqyrësja e punimeve nuk ka kërkuar kryerjen e provave të materialeve dhe certifikatën e cilësisë së tyre, Paragrafi 10,

1.4 - nuk është mbajtur kontabiliteti teknik i punimeve të kryera sipas manualit teknik pasqyra nr 34,35,36,37. Paragrafi 15, shkronja b. Regjistrimin e kontabilitetit.

1.5- nuk është përgatitur sipas modularit të manualit teknik të punimeve të ndërtimit librezë e masave (dokumenti që pasqyron punimet e kryera dhe datat e matjes së tyre),. Ajo nuk pasqyron projektin, punimet filluan dhe mbaruan, kontratën numër, datë, përmbledhësen e zërave të punimeve, në librezën e masave nuk është pasqyruar zëri ndërtim bankinash, etj. Paragrafi 15, shkronja b .

1.6 -nuk është depozituar njoftimi i seksionit të urbanistikës dhe i inspektoratit ndërtimor përpara fillimit të punimeve dhe të depozitohet dosja teknike ,së bashku me plan organizimin e punimeve , sipas ligjit nr. 8402 ,datë 10.09.1998 neni 9 (Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 1). (Për të cilën është mbajtur proces verbali nr. 08, datë 21.09.2011)

D. MASA DISIPLINORE

Shënim: Meqenëse 11 punonjësit të cilët mbajnë përgjegjësi për problemet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, janë larguar nga puna dhe kanë shkëputur marrëdhëniet me Komunën Kryevidh, nuk mund të propozojmë masa disiplinore, pasi ato konsiderohen të ezaurura dhe konkretisht për:

1. [REDAKTUAR] ish kryetari i Komunës Kryevidh.
2. [REDAKTUAR], ish Kryetar i KVO.
3. [REDAKTUAR] ish Përgjegjësi i Financës dhe antar i KVO.
4. [REDAKTUAR] ish jurist i jashtëm në KVO.
5. [REDAKTUAR] Ish kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor, ish antar i NJP.
6. [REDAKTUAR], ish jurist i jashtëm në NJP
7. [REDAKTUAR] ish veteriner, antar i NJP.
8. [REDAKTUAR], ish, Polic.
9. [REDAKTUAR] ish Inspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik.
10. [REDAKTUAR] ish Inspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik.
11. [REDAKTUAR], ish Inspektore e Taksave.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Niko Nako, Besim Bileri dhe Besim Sinani. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Osman Alushi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT